

KONTRATA E SHOQËRISË SË THJESHTË

"Wise Consulting & Law"

Sot më datë 05.10.2023 ortakët themelues:

1. **Znj. Fjoralba Prifti**, lindur në Kukës më 05.06.1977, shtetase shqiptare, banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit H75605043E, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar.
2. **Z. Fatbardh Qinami**, lindur në Palush, Kukës më datë 02.06.1975, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. H50602076W, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Të dy së bashku me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, të shprehur nëpërmjet kësaj kontrate themelimi ranë dakord për krijimin e shoqërisë së thjeshtë "Wise Consulting & Law" bazuar në dispozitat 1074-1112 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

PJESA E PARË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ky akt rregullon pozitën juridike të shoqërisë, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj llojin e partneritetit, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile.

NENI 1 Objekti i veprimtarisë

1.1 Shoqëria e thjeshtë do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj :

a) Ofrimin e konsulencës juridike, përfaqësim para organeve publike si dhe në çdo procedurë administrative që klienti është përfshirë apo përfshihet, përfaqësim në procesin gjyqësor penal, civil, administrativ, kushtetues ose të ndonjë natyre tjetër, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda ose jashtë vendit, pranë gjykatave ndërkombëtare, ose çdo organizmi tjetër pranë të cilit Republika e Shqipërisë ka aderuar, si dhe përfaqësim në procedurat e ndërmjetësimit ose të arbitrazhit, vendase, të huaja apo ndërkombëtare, përgatitjen e kërkesëpadive ose të kërkesave gjatë proceseve gjyqësore, si dhe të kërkesave ankimore, rekurseve kundër vendimeve gjyqësore, atyre të organit të prokurorisë, arbitrazhit ose të organeve të administratës publike, përgatitjen e kërkesave drejtuar Gjykatës Kushtetuese, gjykatave ndërkombëtare dhe çdo organizmi në të cilin aderon Republika e Shqipërisë, përgatitjes së ankesave dhe kërkesave

Fjoralba Prifti

Fatbardh Qinami

për klientin, përpilim të akteve që i nënshtrohen veprimeve noteriale, hartim të kontratave e të marrëveshjeve, si dhe të çdo dokumenti tjetër që sjell ose synon të sjellë pasoja juridike, hartim të çdo dokumenti shkresor sipas kërkesave dhe porosive të klientit, kryerjen e veprimeve të tjera të parashikuara në legjislacionin shqiptar ose në legjislacion e huaj, kur veprimtaria kryhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

b. Ofrimin e çdo lloj konsulence tek personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj , publike dhe /ose private si shoqëritë tregtare, organizmat tregtare qeveritare, organizatat jofitimprurëse , fondacionet, institucionet shtetërore ministritë , departamentet qeveritare dhe autoritetet publike dhe në veçanti konsulence në çështjet organizative, administrimin e biznesit , menaxhimin, marketingun, konsulencë për taksat dhe tatimet si dhe planifikimin e përgjithshëm të tyre, burimet njerëzore dhe konsulencë të përgjithshme për shoqëritë që veprojnë në sektorët e biznesit dhe të industrisë brenda kufizimeve të parashikuara në ligj.

c. Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdo lloj veprimi tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi me qëllim përmbushjen e objektit të veprimtarisë për të cilën është krijuar.

NENI 2

EMRI I SHOQËRISË

2.1 Shoqëria është person juridik privat.

2.2 Emri i shoqërisë është " Wise Consulting & Law".

NENI 3

SELIA E SHOQËRISË

3.1 Selia e saj ndodhet në adresën: Bulevardi 'Dëshmorët e Kombit', Njesia administrative nr.10, Kullat Binjake, Kulla nr. 1, Kati 5, Ap. 10.

Email: fjoralbaprifti23@gmail.com Telefon: 00355682092038

3.2 Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Shqipërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 4


REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË.

4.1 Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim midis të tjerave fitimin.

4.2 Ajo organizohet në formën e shoqërisë së thjeshtë . Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të kontrates se themelimit si dhe dispozitave të legjislacionit në fuqi.

4.3 Me vendimin unanimit të mbledhjes së Asamblesë së Anëtarëve , shoqëria mund të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje





me të plotë me dispozitat e kontrates se themelimit duke bërë përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

4.4 Shoqëria do të ketë vulën e saj.

PJESA II

NENI 5

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARËVE

5.1 Anëtarët mbajnë përgjegjësi për humbjet deri në kufirin e kapitalit të investuar.

5.2 Pasuritë e krijuara nga shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë të pronësi të anëtarëve në raport me kapitalin themeltar të investuar prej tyre.

5.3 Pasuritë mund të tjetërsohen, jepen me qira dhe të lihen peng apo hipotekë me miratimin e Mbledhjes së Asamblesë së Anëtarëve.

NENI 6

KOMPETENCAT E ANËTARËVE

6.1 Anëtarët kanë të drejtat e mëposhtme:

- të administrojnë aktivitetin e Shoqërisë konform objektit të veprimtarisë së saj.
- të administrojnë vlerat e saj intelektuale e ekonomike-financiare.
- të informohen për rezultatet ekonomiko-financiare ne çdo fazë të aktivitetit të saj të marrin pjesë vetë ose me anë të përfaqësuesit në këtë aktivitet.
- të tërheqin të gjitha dokumentet kryesore te shoqërisë.
- të largohen nga Shoqëria dhe të shesin pjesën e kapitalit në bashkëpronësi në përputhje me kushtet që i lejon kontratat e themelimit dhe ligji.

6.2 Anëtarët në përputhje me Kontraten e Themelimit dhe legjislacionin në fuqi kanë të drejtë, që në të njëjtën kohë të zotërojnë kuota/aksione edhe në shoqëri të tjera tregtare.

6.3 Anëtarët kanë të drejtë të paraqesin propozime për shqyrtim para organeve të Shoqërisë si dhe të emërojnë dhe shkarkojnë Administratorin, ose Administratorët , të punësuarit etj.

NENI 7

DETYRIMET E ANËTARËVE

7.1 Anëtarët kanë detyrimet e mëposhtme:

- Të derdhin kapitalin e nevojshëm për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë.
- Të sigurojnë mjediset e nevojshme për fillimin e aktivitetit, infrastrukturën e nevojshme, etj.

Fjoralbe
Albi
Prifti

Fatbardhë Qirani
Q

- Të sigurojnë mundësitë e specializimit të pandërprerë të personelit ndihmës së asistentëve gjithnjë në funksion të rritjes së nivelit dhe cilësisë të veprimtarisë së ushtruar nga ana e shoqërisë; marketingun, reklamën nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informacionit.

NENI 8

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria e thjeshtë do të ushtrojë aktivitetin për një periudhë kohe të pakufizuar.

PJESA III

NENI 9

KUSHTET EKONOMIKE TE SHOQËRISË

- 9.1 Aktiviteti operues i Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut.
- 9.2 Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e kontabilitetit dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

NENE 10

KAPITALI I SHOQËRISË


- 10.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i Anëtarëve themelues në vlerën 1000 (njemije) lekë.
- 10.2 Kuotat janë me vlerë nominative.
- 10.3 Kapitali themeltar ndahet në dy kuota.
- 10.4 Dy kuotat e Shoqërisë janë të ndara si më poshtë:


Kuota e parë : Znj. Fjoralba Prifti në masën 90 % të vlerës së kapitalit themeltar me vlere 900 (nenteqinde) leke.

Kuota e dytë : Z.Fatbardh Qinami, në masën 10 % të vlerës së kapitalit themeltar me vlere 100 (njeqinde) leke.

NENI 11

TRANSFERIMI I KUOTAVE

Fjoralba Prifti


Fatbardh Qinami

4

Anëtarët mund të transferojnë lirisht kuotat e zotëruara me një marrëveshje me shkrim.

NENI 12

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Kapitali themelor mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me vendim të anëtarëve në përputhje me interesat e shoqërisë

PJESA IV

NENI 13

ORGANET E SHOQËRISË

13.1 Organi themelor i Shoqërisë është Mbledhja e Asamblesë së Anëtarëve, e cila mund të mbledhet së çdo kohë kur administratori ose vetë Anëtarët e kërkojnë, duke lajmëruar 15 ditë përpara me shkrim.

13.2 Mbledhja e Asamblesë së Anëtarëve vendos për të gjitha problemet, me përjashtim të atyre që është vendosur ndryshe nga Kontrata e themelimit

PJESA V

NENI 14

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

14.1 Anëtarët me marrëveshje, në përputhje me nenin 1080 të Kodit Civil bien dakord se Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga një Administrator , i cili do të veprojë i vetëm.

14.2 Administratori ka të gjitha se drejtat dhe fuqitë për drejtimin e Shoqërisë, me qëllim që të arrijë objektivat e saj përveç atyre që ligji ua atribuon Asamblesë së Anëtarëve.

14.3 Administratori përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët si dhe para organeve të administratës dhe atyre gjyqësore.

14.4 Shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e organit administrativ.

14.5 Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të kontrates se themelimit apo për dëme të shkaktuara gjatë administrimit të shoqërisë.

14.6 Administratori shkarkohet me vendim të të gjithë Anëtarëve për shkaqe të justifikuara,

14.7 Personi i mëposhtëm emërohet administrator i shoqërisë për një periudhë 3 vjecare me te drejte rimerimi:

Fergalbe Prifti
Abel

Fotkardh Q. Asmu
Be

Znj. Fjoralba Prifti, lindur në Kukës më 05.06.1977, shtetase shqiptare, banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit ID me nr. H756050431E, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

NENI 15

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka këto kompetenca kryesore:

- Te miratojë planin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe t'ia paraqesë sipas rastit për miratim Asamblesë së Shoqërisë.
- Të parashtojë propozime përkatëse për Asamblenë e Anëtarëve në lidhje me rritjet apo zvogëlimet e kapitalit të shoqërisë.
- Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët.
- Të përcaktojë strukturën administrative të shoqërisë dhe të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
- Të sigurojë zbatimin e përpiktë të vendimeve të Asamblesë së Anëtarëve.

PJESA VI

VITI FINANCIAR, BILANCE FITIMI DHE HUMBJET

NENI 16

VITI FINANCIAR, PASQYRAT VJETORE FINANCIARE

16.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj. Ai fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Viti i pari financiar i shoqërisë fillon në ditën e regjistrimit në QKB dhe mbaron më 31 dhjetor.

16.2 Në fund të çdo viti financiar administratori do të përmbushë detyrat e mëposhtme:

- përgatitjen e një liste të detajuar të asetëve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre,
- përgatitjen e bilancit të shoqërisë, i cili përshkruan situatën financiare të shoqërisë,
- përgatitjen e llogarive të fitimeve dhe humbjeve.

NENI 17

FITIMI I SHOQËRISË

Fjoralba Prifti
Prifti

Fatbardhë Dimon
Dimon

Fitimi neto i shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në shoqëri.

PJESA VII

NENI 18

MBYLLJA E SHOQËRISË/LIKUIDIMI

16.1 Kur vendoset mbyllja e shoqërisë, Mbledhja e Asamblesë së Anëtarëve cakton likuidatorin që realizon likuidimin e saj . Shoqëria gjatë likuidimit mban anash emrit të saj edhe emërtimin të saj të saj edhe ‘Shoqëri në likuidim e sipër’. Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

16.2 Kur anëtarët pa shkaqe të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme likuidatori dhe çdo person i besuar mund të kërkojë nga gjykata përfundimin e likuidimit.

16.3 Aktet e përfundimit të likuidimit së bashku me llogaritë përkatëse përfundimtare depozitohen në QKB për çregjistrimin e shoqërisë.

PJESA VIII

Neni 19


19.1 Mosmarrëveshjet për Kontraten e themelimit të Shoqërisë do të zgjidhen nga vetë anëtarët me mirëkuptim dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen nga gjykata kompetente.

19.2 Gjykata kompetente është Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

19.3 Kjo Kontrate hartohet dhe nënshkruhet në 4 kopje.

ANËTARËT

FJORALBA PRIFTI



FATBARDH QINAMI

